



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Raporti i analizës së projektligjit

<b>PËR</b>	<b>Komisioni për Buxhet, punë dhe transfere</b>	<b>Datë</b>	<b>7 korrik 2021</b>
		<b>Referencë</b>	<b>08/L0-16</b>
<b>PËRMES</b>	<b>Zoja Osmani-Drejtoreshë, Drejtoria për Shërbime juridike dhe përafrim të legjislacionit</b>		
<b>NGA</b>	<b>F. HAMITI &amp; F. MEHMETI Këshilltarë juridik, Drejtoria për Shërbime juridike dhe përafrim të legjislacionit</b>		
<b>Subjekti</b>	<b>Raport për analizën e projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.</b>		

Në bazë të Rregullores për Organizimin dhe përgjegjësitë e administratës së Kuvendit, Drejtoria për Shërbime juridike dhe përafrim të legjislacionit, e përgatitë raportin për analizën e projektligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme Projektligji).

#### **1. ASPEKTI FORMALO-JURIDIK I PROJEKTLIGJIT**

Projektligji është dorëzuar në Kuvend më, 30.06.2021, dhe u është shpërndarë deputetëve po të njëjtën ditë më, 30.06.2021, i shoqëruar edhe me tabelat përcjellëse, por **pa memorandum shpjegues!** Komisioni për buxhet, punë dhe transfere në mbledhjen e mbajtur më, 2 Korrik 2021,

e premte, ora 14:00, ka shqyrtuar projektligjin në parim dhe me 4 vota “për”, 2 “ abstenim” dhe 0 “kundër”, ka vendosur që të procedojë për votim në parim në seancë.

## **2. STRUKTURA E PROJEKTLIGJIT**

### **2.1. Struktura sipas ndarjes formale**

Projektligji është i strukturuar në 14 nene, 9 nga të cilat kanë për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e neneve ekzistuese në ligjin e plotësuar dhe ndryshuar, ndërsa 4 nga to janë nene të reja, pa pasur referencë në ligjin bazik, ndërsa neni i fundit, përkatësisht neni 14 parashih hyrjen në fuqi të ligjit.

### **2.2. Struktura sipas dispozitave**

Projektligji nuk i është përmbajtur në tërësi Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, sipas të cilit udhëzim parashihen kriteret që iu duhet përmbajtur projektligji që ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e ligjit/eve ekzistues/e. Rrjedhimisht disa nga normat në Projektligj janë norma të reja, që kanë për qëllim plotësimin e tij, por pa referencë të saktë në strukturimin e këtyre normave brenda dispozitave të ligjit të ndryshuar dhe plotësuar.

## **3. PËRAFRIMI I PROJEKTLIGJIT ME LEGJISLACIONIN E BE-SË**

3.1. Çështjet që rregullojnë dispozitat e Projektligjit nuk parashihen me legjislacionin e BE-së.

## **4. REKOMANDIME LIDHUR ME PËRMBAJTJEN E PROJEKTLIGJIT DHE FORMULIMIN GJUHËSORO-JURIDIK**

### **4.1. Vërejtje të përgjithshme**

- Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, përkatësisht nenit 10, paragrafit 4, ku thuhet që: “gjatë ndryshimit dhe plotësimit të akteve normative, nenet e reja duhet të futen në vendin e tyre sistematik, duhet të marrin numrin e nenit pas të cilit ata vendosen. Shkronja e madhe e radhës e alfabetit duhet t’i bashkëngjitet numrit”.<sup>1</sup> Në projektligj, nenet 10, 11, 12 dhe 13 nuk i janë përmbajtur kësaj rregulle dhe si të tilla bien në kundërshtim më këtë udhëzim, që si pasojë shkaktojnë edhe pasiguri juridike. Rekomandojmë që sponsorizuesi të sqarojë së ku ka paraparë t’i vendosë këto dispozita, përkatësisht pas cilit nen.
- Gjithashtu neneve 8 dhe 9 i janë vendosur emërtimet, kjo nuk është praktikë dhe rekomandojmë që të ndiqen shembujt e neneve paraprake të projektligjit. Emërtimi i neneve të dispozitave shpjeguese është i panevojshëm.
- Ndryshimi dhe plotësimi i neneve, përkatësisht dispozitave bëhet sipas radhitjes kronologjike të tyre në ligjin bazik, duke filluar nga neni me numër rendor me të vogël duke vazhduar me radhe me numrat tjerë pasues. Në projektligj ndryshimi dhe plotësimi i neneve nuk është bërë sipas këtij parimi, andaj shih: neni 5 i projektligjit ndryshon dhe plotëson nenin 18, ndërsa nenet vijuese, respektivisht neni 6 ndryshon nenin 12, neni 7 nenin 15 si dhe neni 8 nenin 16.

---

<sup>1</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8696>.

## **4.2.Vërejtje të konkrete**

### **Neni 9 - Emetimi i letrave me vlerë**

- **Propozojmë korrighimin e referencës në dispozitën shpjeguese**

Paragrafi 1- Dispozita shpjeguese thotë që Neni 21 të ligjit bazik, pas paragrafit të parë i shtohet një paragrafi i ri si në vijim. Mirëpo, neni i synuar për ndryshim në ligjin bazik është neni 23 e jo neni 21. Propozojmë korrighimin e referencës, dhe ne vend të nenit 21 të jetë neni 23, me vet faktin se qëllimi i kësaj dispozite është plotësimi i nenit 23 duke i shtuar një paragraf të ri.

- **Të numërohet paragrafi i shtuar me 1A e jo si paragraf 2**

Duke marrë parasysh paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013, për hartimin e akteve normative<sup>2</sup>, kur kemi shtim të paragrafëve, pikave, ose shkronjave të reja, atëherë ato futen pas paragrafëve, pikave ose shkronjave ekzistuese duke i vendosur shkronjën e madhe të radhës së alfabetit. Në rastin konkret paragrafi i shtuar në nenin 21, respektivisht 23 të korrighuar sipas vërejtjes paraprake, duhet të numërohet si 1A, ndërsa paragrafi 2. i këtij neni që propozon ri-radhitjen e paragrafëve pasues të këtij neni të fshihet, sepse mbetet i panevojshëm dhe krijon pasiguri në referim.

- **Të zëvendësohet “parë” me “1”.**

Në dispozitën shpjeguese të nenit 9 të projektligjit nder të tjera thuhet që “Neni 21 të Ligjit Bazik, pas paragrafi **të parë**, i shtohet një paragraf i ri si në vijim.....”:

Paragrafi shënohet me numër e jo me shkronja, andaj propozojmë përdorimin e saktë kur i referohemi identifikimit të paragrafit.

Shënim: Vërejtjet e tjera eventuale do të adresohen gjatë punimeve të grupit punues.

---

<sup>2</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8696>

## 5. VËREJTJE LIDHUR ME VERSIONIN NË GJUHËN ANGLEZE DHE SERBE

### 5.1. Vërejtje lidhur me versionin në gjuhën angleze

Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 është përkthyer shumë mirë. Në tekstin e projektligjit ka shumë pak gabime të natyrës përmbajtësore dhe teknike. Në tekstin e Projektligjit janë bërë korrigjime të disa gabimeve apo lëshimeve eventuale siç janë ato përmbajtësore, gramatikore apo drejtshkrimore, mirëpo nuk shihet e arsyeshme të ceken në këtë raport. Pra, nuk shihet e arsyeshme të hartohet raport preliminar me vërejtje dhe rekomandime për projektligjin në fjalë.

Shënim: Vërejtjet në gjuhën angleze adresohen nga znj. Vjollca Sogojeva, zyrtare për harmonizim gjuhësor.

### 5.2. Vërejtjet në gjuhën serbe

**Rekomandim 1:** Teksti i nenit 5, paragrafi 8 i shtuar të këtij Projektligji “*U svrhu godišnjeg finansijskog izveštavanja za 2021. godinu, transakcije i računovodstvene knjige koje su prenesene na novo ministarstvo u skladu sa paragrafom 7, u godišnjim finansijskim izveštajima treba detaljno obelodaniti, kako bi se utvrdile računovodstvene evidencije i omogućila transparentnost, odgovornost i odgovornost tokom izvršenja budžeta od strane nadležnog ministarstva u vreme rada, za izdatke nastale u okviru ovlašćenja Osnovnog zakona.*” të zëvendësohet me tekstin e riformuluar si vijon:

“U svrhu godišnjeg finansijskog izveštavanja za 2021. godinu, transakcije i računovodstvene knjige prenete novom ministarstvu u skladu sa stavom 7. treba detaljno prikazati u godišnjim finansijskim izveštajima, u cilju preseka računovodstvenih zapisa i omogućavanja transparentnosti, polaganje računa i odgovornost prilikom izvršenja budžeta od strane predmetnog ministarstva u vreme funkcionisanja, za rashode nastale u nadležnosti osnovnog zakona.”

**Rekomandim 2:** Teksti i nenit 6 i këtij Projektligji “*Stavovi 11 i 12 zakonske odredbe broj 12 Osnovnog zakona se ukidaju.*“ të zëvendësohet me tekstin e riformuluar si vijon:

“Član 12. stavovi 11. i 12. osnovnog zakona stavlja se van snage.“

**Rekomandim 3:** Teksti i nenit 7, paragrafi 5 i shtuar të këtij Projektligji “*Ministarstvo finansija, rada i transfera je ovlašćeno za međunarodne finansijske sporazume predviđene ovim zakonom (Tabela 1.1) za finansiranje pandemije ili ekonomskog oporavka, povezane sa Međunarodnom asocijacijom za razvoj, Razvojnem bankom Saveta Evrope, Evropskom investicijskom Banka i Evropska banka za obnovu i razvoj, nakon njihove ratifikacije i efektivne primene, kroz Program ekonomskog oporavka budžetiraju se i dodeljuju na nadoknadu kao retroaktivno finansiranje izdataka državnih grantova od strane odgovornih budžetskih organizacija (namenjenih za COVID-19 ili ekonomski oporavak) i zameni ih izvorom kreditnog finansiranja, u fiskalnoj 2021. godini.*“ të zëvendësohet me tekstin e riformuluar si vijon:

“Ovlašćuje se Ministarstvo finansija, rada i transfera da za međunarodne finansijske sporazume predviđene ovim zakonom (Tabela 1.1.) za finansiranje pandemije ili ekonomskog oporavka, sklopljene sa Međunarodnim udruženjem za razvoj, Razvojnem bankom Saveta Evrope, Evropskom investicijskom bankom i Evropskom bankom za obnovu i razvoj, prilikom ratifikacije i stupanja na snagu istih, putem Programa za ekonomski oporavak, budžetiraju se i izdvajaju za isplatu kao retroaktivno finansiranje rashoda iz vladinog granta od strane nadležnih budžetskih organizacija (namenjenih za COVID-19 ili ekonomski oporavak) i iste zamene izvorom finansiranja putem kredita, unutar fiskalne 2021. godine.“

**Rekomandim 4:** Teksti i nenit 9, paragrafi 2 të këtij Projektligji “*Stavovi 2 i 3 člana 21 Osnovnog zakona prebrojavaju se u 3, odnosno 4.*“ të zëvendësohet me tekstin e riformuluar si vijon:

“Član 21. stavovi 2. i 3. osnovnog zakona postaju stavovi 3, odnosno 4.“

**Rekomandim 5:** Teksti i nenit 11, paragrafi 1 të këtij Projektligji “*Ministarstvo finansija, rada i transfera i Centralna banka Republike Kosovo su ovlašćeni, putem Memoranduma o razumevanju, u slučaju da Međunarodni monetarni fond dodeljuje „Specijalna prava vučenja (SDR)“ za Republiku Kosovo, da izvrši korišćenje prihoda, u skladu sa potrebama budžeta Republike Kosovo, preko CBK-a kao fiskalnog agenta, u skladu sa članom 4. Zakona br. 03 / L-152 o članstvu Republike*

*Kosovo u Međunarodnom monetarnom fondu i organizacijama Svetske banke.*“ të zëvendësohet me tekstin e riformuluar si vijon:

“Ovlašćuju se Ministarstvo finansija, rada i transfera i Centralna banka Republike Kosovo, da putem Memoranduma o razumevanju, u slučaju da Međunarodni monetarni fond dodeli Republici Kosovo „Posebna prava vučenja (SDR)“, sprovedu postupak za njihovo korišćenje shodno potrebama budžeta Republike Kosovo, putem CBK-a kao fiskalnog agenta, u skladu sa članom 4. Zakona br. 03/L-152 o učlanjenju Republike Kosovo u Međunarodnom monetarnom fondu i organizacijama grupe Svetske banke.“

**Vërejtje:** Korrigjimi i gabimeve apo lëshimeve të tjera është bërë në tekstin e Projektligjit.

Shënim: Vërejtjet në gjuhën serbe adresohen nga z. Armend Miftari, zyrtar për harmonizim gjuhësor